



Planuar / Dorezuar Punë/Prodato Received/Delivered	30.12.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SPRINTSHOCK	8689/2022		113



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1083/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë me Ilire Mehmeti Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, bazuar në Aktgjykimin A.nr.653/2021 të datës 01.12.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, në rivendosje lidhur me ankesën me numër A.nr.26/2021 të datës 25.01.2021, të parashtruar nga ankuesi të cilën me autorizim e përfaqëson Studio e Avokatisë "Avokatura.

organit të punësimit/ Agjencia e Statistikave të Kosovës, në çështjen juridike "Ndërprerje e marrëveshjes së punës" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 30.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **shpallet jo kompetent** për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.26/2021 të datës 25.01.2021 të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi më datë 25.01.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 283/2021 të regjistruar nën shenjen A.nr.26/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të shkëputjes së Marrëveshjes për Shërbime të Veçanta, me numër protokollit 04-052-3125 e datës 09.09.2019, e lidhur në mes të ankuesit në njërin anë dhe Agjencisë së Statistikave të Kosovës në anën tjetër.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 15.02.2021 ka nxjerr Vendimin A.nr.26/2021 me të cilin është shpall jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit, për arsye se objekt kontesti është Marrëveshja për Shërbime të Veçanta, me numër protokollit 04-052-3125 e datës 09.09.2019, dhe rrjedhimisht ankuesi si nënshkruer i kësaj marrëveshje nuk e ka statusin e nëpunësit civil.



Ankuesi kundër Vendimi A.nr.26/2021 të datës 25.01.2021 ka hapur konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Kjo e fundit më datë 01.11.2022 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.653/2021 (të pranuar me datë 01.12.2022) me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit ka anuluar Vendimin A.nr.26/2021 të datës 25.01.2021 të Këshillit, dhe çështjen e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në ri procedurë, duke ju referuar provave të lëndës, konstatoi se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi *sepse:*

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedh se ankuesi Mehmet Rexhepi ka qenë i emëruar në Agjencinë e Statistikave të Kosovës sipas Marrëveshjes për Shërbime të Veçanta me numër protokolli 04-052-3125 të datës 09.09.2019.

Me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (i aplikueshëm deri me datë 09.07.2020) përkatësisht nenin 12 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 dhe 1.2 është përcaktuar se: 1. Në Shërbimin Civil të Kosovës ekzistojnë dy kategori të punësuarve:

- 1.1. pozitave e nëpunësve civilë të karrierës - të cilët ushtrojnë funksionet në baza të përhershme për arritjen e objektivave të përgjithshme institucionale; dhe
- 1.2. pozitave e nëpunësve civilë të jo karrierës - të cilët ushtrojnë funksionet me kohëzgjatje të kufizuar deri në dy (2) vjet, për zbatimin e projekteve të caktuara, zëvendësimi i përkohshëm i nëpunësve të përhershëm civilë dhe në raste të mbingarkesave në punë.

Ndërsa me paragrafin 4 të njëjtit nen përcaktohet se: 4. Emërimet me afat të caktuar për një periudhë më të shkurtër se gjashtë (6) muaj do të bëhen në bazë të kontratave të quajtura "Marrëveshje për shërbime të veçanta" të cilat i nënshtrohen Ligjit për Detyrimet dhe për të cilat zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit.

Në kuptim të këtyre dispozitave ligjore rrjedh se Marrëveshjet për Shërbime të Veçanta i nënshtrohen Ligjit për Detyrimet dhe se të emëruarit sipas këtyre marrëveshjeve nuk hyjnë në asnjërën nga dy kategoritë e të punësuarve në Shërbimin Civil, dhe si rrjedhojë nuk e kanë statusin e nëpunësit civil.

Qëndrimi juridik i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, se të emëruarit sipas Marrëveshjeve për Shërbime të Veçanta nuk e kanë statusin e nëpunësit civil është konfirmuar edhe me Aktgjykimin ARJ-UZVP.nr.26/2018 të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Për më tepër në Marrëveshjen për Shërbime të Veçanta me numër protokolli 04-052-3125 të datës 09.09.2019, e lidhur në mes të ankuesit në njëërën anë dhe Agjencisë së Statistikave të Kosovës në anën tjetër, përkatësisht nenin 14 përcaktohet se ... në rast të kontestit eventual palët janë dakord që kompetent të jetë Gjykata Themelore në Prishtinë.

Andaj, duke marr parasysh faktin e pa kontestuar se ankuesi ka qenë i emëruar në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, sipas Marrëveshjes për Shërbime të Veçanta, me numër protokolli 04-052-3125 të datës 09.09.2019, dhe objekt i këtij kontesti është pikërisht shkëputja e kësaj marrëveshje, me ç'rast u vërtetua me lartë se të njëjtat nuk hyjnë në asnjërën nga dy kategoritë e të punësuarve në Shërbimin Civil, por që i nënshtrohen Ligjit për Detyrimet, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se ankuesi nuk e ka statusin e nëpunësit civil, dhe si rrjedhojë Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.26/2021 të datës 25.01.2021 të parashtruar nga ankuesi ngase bazuar në dispozitat e Ligjit



Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përkatësisht nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, Këshilli shqyrton dhe merr vendime vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil.

Kolegji i Këshillit, po ashtu thekson faktin se në çdo rast kur nga provat e administruara konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit, vendos të shpallet jo kompetent sipas dispozitave të ligjit të veçantë, përkatësisht nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Rrjedhimisht, në rastet kur konstatohet se pala ka shfrytëzuar mjete juridike brenda organit publikë, e njëjta palë vetëm udhëzohet për ushtrimin e mjeteve juridike në gjykatën kompetente, ndërsa lënda nuk mund të bartë tek organi përkatës ngase në këtë fazë mungon padia si kusht kryesor për fillimin e një procesi gjyqësor.

Andaj, duke marr parasysh tani më konstatimin se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka juridiksion për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.26/2021 të datës 25.01.2021, dhe meqenëse nga shkresat e lëndës vërehet se ankuesi ka shfrytëzuar mjetet juridike brenda organit të punësimit, Kolegji i Këshillit udhëzon ankuesin për ushtrimin e mjeteve juridike në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe dispozitat e Ligjit për Marrëdhënien e Detyrimeve.

Për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1083/2022

Ilire Mehmeti - Shaqiri

Procesmbajtëse

Jeton Koca

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit Studio e Avokatisë "
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë e Statistikave të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së;